



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.986/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar e kolegjit, Franciska Zhtija – Ymeri dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurimit N.T.SH. "Doni Commerce", me NUT:811285065, me seli ne Skenderaj, rruga "28 Nëntori" te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Dina, avokat ne Prishtine, kundër kundërshtarit të sigurimit Komuna e Glllogocit, me seli ne Glllogoc, perfaqësuar nga kryetari i komunës R.Ll., duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarit të sigurimit e paraqitur, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e shkallës së parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.985/23 e datës 08.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e kundërshtarit të masës së sigurisë Komuna e Glllogocit, me seli ne Glllogoc dhe

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, KE.nr.985/23 e datës 08.03.2024, dhe vendoset si vijon:

REFUZOHET si i pabazuar propozimi i palës propozuese, për caktimin e masës së sigurisë, ndaj kundërshtarit të sigurimit, me të cilën ka kërkuar i NDALOHET kundërshtarit te masës se sigurimit Komuna e Glllogocit, konfiskimi i sigurimit te ekzekutimit te tenderit "Ndërtimi i Kolektorëve kryesor te Ujerave te Zeza ne mes te Komunës se Glllogocit dhe Skenderajt - projekt dy vjeçar" me numër identifikimi 611-18-073-521, numër te polices 060030040091609 te datës 27.06.2023, ne vlere prej 25,983.00 € (njëzet e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjete e tre euro), sipas Vendimit me numër 02-400-58600, te datës 05.12.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KE.nr.985/23 e datës 08.03.2024, në piken I të dispozitivit të aktvendimit e APROVOHET si i bazuar propozimi i propozuesit te masës se sigurimit N.T.SH. "Doni Commerce", i paraqitur kundër kundërshtarit te masës se sigurimit Komuna e Glllogocit, CAKTOHET masa e sigurimit dhe i NDALOHET kundërshtarit te masës se sigurimit Komuna e Glllogocit, konfiskimi i sigurimit te ekzekutimit te tenderit "Ndërtimi i Kolektorëve kryesor te Ujerave te Zeza ne mes te Komunës se Glllogocit dhe Skenderajt - projekt dy vjeçar" me numër identifikimi 611-18-073-521, numër te polices 060030040091609 te datës 27.06.2023, ne vlere prej 25,983.00 € (njëzet e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre euro), sipas Vendimit me

numër 02-400-58600, te datës 05.12.2023. ndërsa ne piken e II te dispozitivit ka vendosur qe masa e sigurimit mbetet ne fuqi deri sa mos te jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kundërshtari i sigurimit, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e shkallës së dytë, aktvendimin e atakuar KE.nr.985/23 e datës 08.03.2024 ta anuloj dhe të refuzoj propozimin e propozuesit te apo lenden te kthej ne rivendosje dhe rigjykim, ne gjykatën e shkalles se pare.

Propozuesi i sigurimit nuk ka ushtruar përgjigje ne ankesë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesja e masës së sigurimit me datë 08.12.2023, ka paraqitur padi, kundër të paditurës, me propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Ne propozimin për caktimin e masës ka kërkuar i NDALOHET kundërshtarit te masës se sigurimit Komuna e Glllogocit, konfiskimi i sigurimit te ekzekutimit te tenderit "Ndërtimi i Kolektorëve kryesor te Ujerave te Zeza ne mes te Komunës se Glllogocit dhe Skenderajt - projekt dy vjeçar" me numër identifikimi 611-18-073-521, numër te polices 060030040091609 te datës 27.06.2023, ne vlere prej 25,983.00 € (njëzet e pesë mije e nëntëqind e tetëdhjete e tre euro), sipas Vendimit me numër 02-400-58600, te datës 05.12.2023.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre ne menyre verbale dhe shkresore, sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e ankimuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 297 par.1 pika a) dhe b) dhe nenit 301 të LPK-së, si dhe duke arsyetuar aktvendimin e ankimuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë e mori këtë qëndrim juridik sepse sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këitillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshihjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore, sipas të cilave propozuesi i sigurimit duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besueshëm faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij, andaj në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë, me vendimin e atakuar, pa të drejtë ka vendosur se janë përmbushur konditat ligjore sipas nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, kur ka aprovuar kërkesën për caktimin e masës së sigurimit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, me një kujdes të shtuar i ka analizuar edhe pretendimet ankimore në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe erdh në përfundim se këto pretendime qëndrojnë, sepse masa siguroese është mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të kërkesëpadisë dhe kjo masë mund të caktohet vetëm po që se propozuesi i masës e bënë të besueshme të drejtën e tij subjektive dhe paraqet prova apo rrethana që e bindin gjykatën se ekziston rreziku serioz se kundërshtari i sigurimit me veprimin apo mos veprimin e tij mund t'ia pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesëpadisë.

Në rastin konkret propozuesi i masës së sigurimit nuk ka ofruar prova konkrete me te cilën e do te bënte te besueshme kërkesën apo te drejtën subjektive, kjo për faktin se ne këtë rast ne baze te deklarimeve dhe provave ne shkresa te lendes rezulton se propozuesi i sigurimit sipas Kontratës me numër identifikues 611-18-073-521 të datës 07.11.2018, ka pasur për detyre përfundimin e punëve sipas afatit te përcaktuar ne kontrate dhe bazuar ne shkresat e lendes te prezantuara nga kundërshtarja e sigurimit rezulton se i njëjti nuk ka qene i papërgjegjshëm ne kryerjen e punimeve sipas kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara ne kontrate, andaj menaxherja e kontratës (ne këtë rast zyrtarja e kundërshtares se sigurimit) Florije Krasniqi, ka kërkuar nga Zyra e Prokurimit, qe te kërkohet nga siguroesi përmbushja e detyrimit sipas polices se sigurimit me numër 060030040091609. Po ashtu nga provat e lendes rezulton se për verifikimin e zhvillimit te punimeve sipas projektit, nga pala kundërshtare, me sakte nga organi kompetent - Drejtori i Drejtorisë për Infrastruktura Lokale është formuar edhe komisioni prej 3 anëtarësh, ku duke marre parasysh shqetësimet e ngritura për mos implementimin e projektit dhe mos përgjigjes ndaj komisionit për verifikim, operatori ekonomik është konsideruar si i papërgjegjshëm, neglizhues dhe jo profesional dhe ishte kërkuar ndërmarrja e masave ndaj te njëjtit duke e tërhequr policen e sigurimit dhe mbi këtë baze sipas këtyre kërkesave Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me date 05.12.2023, ka nxjerr vendim me numër 02-400-58600 te datës 05.12.2023 për konfiskimin e sigurimit te ekzekutimit te tenderit me numër te polices 060030040091609 te lëshuar nga Kompania e Sigurimeve "SIGKOS", e duke pas parasysh faktin se në rastin konkret është përcaktuar ne policen e sigurimit, se garacioni do te ekzekutohet me kërkesën e pare te autoritetit kontraktues, i njëjti nuk përbën garacion me kusht, për ekzekutimin e te cilit kërkohet qe te vërtetohet ne mënyrë objektive, dështimi i operatorit ekonomik ne ekzekutimin e kontratës dhe shkaktimi i dëmeve autoritetit kontraktues si pasoje e mos ekzekutimit te të njëjtës.

Prandaj për vlerësimin e gjykatës propozuesi nuk e bere te besueshme te drejtën e tij subjektive, e po ashtu nuk e ka bere te besueshme se kundërshtarit te sigurimit vërtetë mund të pamundësoj apo vështirësoj dukshëm realizimin e kërkesës në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do mund të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të mund të

ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses së sigurimit, se do të ndikonte në pamundësinë e realizimit i kërkesës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë ka të meta për shkak të së cilave është vlerësuar ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b), për caktimin e masës së sigurisë.

Andaj, bazuar në të lartcekurat dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës ë parë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë,
Kom.Dh.Shk.II.nr.986/2024, dt.15.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Faton Bajrami, d.v